



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, dhe nenit 8 të Rregullores Nr. 01/2017 për Marrëdhënie Pune, si dhe në përputhje me Vendimin e datës 14.07.2017, Zyra Kombëtare e Auditimit, shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës

Pozita:	Teknik i Auditimit
Kodi:	AUD/ZKA/13-07/17
Grada:	ZKA/08
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja e emërimit:	Kohë e caktuar – deri më 30 qershor 2018
Vendi:	Prishtinë

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga UE (nën mbikëqyrje dhe me përkrahje);
- Përfundimi dhe indeksimi i letrave të punës në fushat e caktuara të auditimit;
- Zbatojnë të gjitha standardet e cilësisë të përcaktuara me Doracakun e auditimit të rregullsisë;
- Zbaton të gjitha rregulloret, udhëzimet, politikat dhe procedurat e brendshme të përcaktuara nga ZKA;
- Shfrytëzimi i teknikave të sakta analitike në bazë të dëshmive të mbledhura;
- Përgatitja e LP (memo përmbledhëse) lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese, e cila i është caktuar; dhe
- Përfundimi dhe indeksimi i letrave të punës dhe diskutimi me kohë me Udhëheqësin e tij/saj.

Kërkesat themelore:

1. Diplomë fakulteti
2. Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale;
3. Preferohet të ketë njërën nga skemat e certifikimit për kontabilist, auditor apo auditor i brendshëm.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës për pozitën e shpallur bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e konkurrimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar me një biografi personale (CV), një letër motivuese, si dhe dokumentacionin përkatës për kualifikimin dhe përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Zyrës Kombëtare të Auditimit: <http://www.zka-rks.org/>

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: rekrutimi@oagks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në Zyrën Kombëtare të Auditimit, në rrugën Musine Kokalari nr. 87, kati II, prej orës 08:00 – 16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025 dhe 038/606-004, ext:1005.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në shtypin ditor.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Divizioni për Burime Njerëzore.